



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21.5.2023

Nr: 542

Ora: 12:30

VENDIM  
PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR  
KRYETARIN E BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA  
TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 21.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja, “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**VËREJ:**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 13 (trembëdhjetë) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 29, ZAZ nr.30, ZAZ nr. 31, ZAZ nr. 32, ZAZ nr. 33, ZAZ nr. 34, ZAZ nr. 35, ZAZ nr.36, ZAZ nr. 37, ZAZ nr. 38, ZAZ nr. 39, ZAZ nr. 40 dhe ZAZ nr. 41.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Tiranë.

Data: 21.5.2023 Nr: 542  
Ora: 12:30



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimi dhe nxjerrja e rezultatit të votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

KZAZ nr. 29, KZAZ nr. 30, KZAZ nr. 31, KZAZ nr. 32, KZAZ nr. 33, KZAZ nr. 34, KZAZ nr. 35, KZAZ nr. 36, KZAZ nr. 37, KZAZ nr. 38, KZAZ nr. 39, KZAZ nr. 40 dhe KZAZ nr. 41, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Tiranë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e Bashkisë Tiranë, u kontrolluan Tabelat Përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 29, ZAZ nr. 30, ZAZ nr. 31, ZAZ nr. 32, ZAZ nr. 33, ZAZ nr. 34, ZAZ nr. 35, ZAZ nr. 36, ZAZ nr. 37, ZAZ nr. 38, ZAZ nr. 39, ZAZ nr. 40 dhe ZAZ nr. 41, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve çdo QV-je të zonës zgjedhore.

Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Tabela Përmbledhëse e Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Tiranë, Qarku Tiranë, miratohet me vendim nga KQZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Erion Veliq si Kryetar i Bashkisë Tiranë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Tiranë, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 21.5.2023 Nr: 542  
Ora: 12:30



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”



## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

#### BASHKIA TIRANË, QARKU TIRANË



Lidhja 1

		ZAZ 29	ZAZ 30	ZAZ 31	ZAZ 32	ZAZ 33	ZAZ 34	ZAZ 35	ZAZ 36	ZAZ 37	ZAZ 38	ZAZ 39	ZAZ 40	ZAZ 41	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	77.551	65.377	41.920	68.732	38.196	53.527	72.173	55.798	63.664	34.089	53.745	23.642	51.352	<b>699.766</b>
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	37.376	33.575	17.875	29.821	15.894	20.072	32.168	22.079	26.698	13.991	23.303	9.986	19.857	<b>302.695</b>
3	Vota të pavlefshme	1.543	1.552	757	1.113	582	827	1.233	896	958	518	867	292	801	<b>11.939</b>
4	Vota të vlefshme	35.783	31.985	17.101	28.730	15.297	19.215	30.880	21.168	25.709	13.456	22.409	9.684	19.029	<b>290.446</b>
5	Fletë votimi të hedhura gabim	50	38	17	7	15	30	55	15	31	17	27	10	27	<b>339</b>
1	Arlind Muhamet Qori	1.319	1.226	802	1.618	678	912	1.933	765	1.558	618	1.171	509	742	<b>13.851</b>
2	Marko Sali Dajti	529	692	170	163	128	185	140	216	130	79	149	41	187	<b>2.809</b>
3	Lajla Ylber Pernaska	152	171	166	316	135	118	292	89	197	100	175	87	109	<b>2.107</b>
4	Erion Luan Veliaj	20.731	19.402	9.588	14.839	8.910	10.439	16.684	12.543	12.913	6.477	11.417	5.077	9.836	<b>158.856</b>
5	Belind Zamir Këlliçi	11.659	9.249	5.668	10.560	4.839	6.750	10.455	6.811	9.645	5.391	8.523	3.629	7.246	<b>100.425</b>
6	Roland Hysen Bejko	1.393	1.245	707	1.234	607	811	1.376	744	1.266	791	974	341	909	<b>12.398</b>
	<b>Totali i votave të vlefshme</b>	<b>35.783</b>	<b>31.985</b>	<b>17.101</b>	<b>28.730</b>	<b>15.297</b>	<b>19.215</b>	<b>30.880</b>	<b>21.168</b>	<b>25.709</b>	<b>13.456</b>	<b>22.409</b>	<b>9.684</b>	<b>19.029</b>	<b>290.446</b>

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



## ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

### TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

#### BASHKIA TIRANË, QARKU TIRANË



Lidhja 2

		ZAZ 29	ZAZ 30	ZAZ 31	ZAZ 32	ZAZ 33	ZAZ 34	ZAZ 35	ZAZ 36	ZAZ 37	ZAZ 38	ZAZ 39	ZAZ 40	ZAZ 41	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	77.551	65.377	41.920	68.732	38.196	53.527	72.173	55.798	63.664	34.089	53.745	23.642	51.352	<b>699.766</b>
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	37.370	33.569	17.887	29.827	15.911	20.079	32.152	22.085	26.695	13.996	23.302	9.989	19.836	<b>302.698</b>
3	Vota të pavlefshme	1.404	1.419	649	943	470	707	1.042	768	828	414	706	234	747	<b>10.331</b>
4	Vota të vlefshme	35.914	32.122	17.225	28.906	15.418	19.331	31.078	21.295	25.828	13.559	22.566	9.745	19.065	<b>292.052</b>
5	Fletë votimi të hedhura gabim	52	28	13	6	23	41	32	22	39	23	30	10	24	<b>343</b>
1	Bashkë Fitojmë	7.457	6.474	3.603	7.269	3.274	4.343	7.162	4.638	6.587	3.689	5.841	2.621	5.042	<b>68.000</b>
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	19.652	18.022	8.555	13.618	8.233	9.515	15.673	11.588	12.022	5.847	10.740	4.847	8.960	<b>147.272</b>
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	321	390	233	397	195	331	342	187	323	160	237	109	171	<b>3.396</b>
4	Partia Republikane Shqiptare	673	593	220	363	140	283	377	353	313	139	448	94	458	<b>4.454</b>
5	Partia Levizja e Legalitetit	495	502	183	357	121	422	215	271	261	120	257	50	275	<b>3.529</b>
6	Partia Demokracia Sociale	231	235	70	138	52	94	142	120	117	45	114	50	101	<b>1.509</b>
7	Aleanca Liberale e Djathtë	104	76	33	49	30	43	74	46	86	27	52	21	53	<b>694</b>
8	Partia Socialdemokrate	1.516	1.406	1.579	1.159	868	1.114	1.107	1.110	751	444	639	219	884	<b>12.796</b>
9	Partia Demokratike	2.924	2.154	986	1.997	897	1.277	1.831	1.357	1.821	1.153	1.501	510	1.419	<b>19.827</b>
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	312	296	266	700	294	242	709	144	495	370	487	286	159	<b>4.760</b>
11	Fryma e Re Demokratike	291	126	66	134	66	120	205	83	179	90	195	34	146	<b>1.735</b>
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	320	372	429	612	405	237	618	387	646	382	320	190	395	<b>5.313</b>
17	Aleanca Arbnore Kombëtare	220	186	103	145	63	130	252	104	192	140	214	50	158	<b>1.957</b>
18	Partia Balli Kombëtar	50	47	35	56	28	99	60	33	41	21	36	13	36	<b>555</b>
24	Partia Konservatore	160	216	90	191	56	169	128	150	147	173	97	42	104	<b>1.723</b>
35	Nisma Thurje	630	491	368	768	312	484	1.058	346	892	388	635	260	361	<b>6.993</b>
36	Lëvizja Bashkë	558	536	406	953	384	428	1.125	378	955	371	753	349	343	<b>7.539</b>
	<b>Totali i votave të vlefshme</b>	<b>35.914</b>	<b>32.122</b>	<b>17.225</b>	<b>28.906</b>	<b>15.418</b>	<b>19.331</b>	<b>31.078</b>	<b>21.295</b>	<b>25.828</b>	<b>13.559</b>	<b>22.566</b>	<b>9.745</b>	<b>19.065</b>	<b>292.052</b>

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI